




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Zico TV” SH.P.K.

Pronar – Nexhmedin ISMAJLI  
OSHMA ZICO TV  
Rr/ Skenderbeu, Nr.32  
Gjilan

Ref: 1905/629/LIC/ni

### VENDIM

për miratimin e kërkesës për ndryshimin e skemës programore të ZICO TV (Parashtruesi i Kërkesës), me seli në Gjilan

---

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. ZICO TV është Ofrues i Shërbimit Medial Adiovizual i cili është i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për të ofruar programe televizive përmes operatorëve të shpërndarjes me seli në Prishtinë. Zico TV është pajisur me licencë të KPM-së me datën 15 dhjetor 2008.
3. Më datën 2 tetor 2018, ZICO TV ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e skemës programore, si dhe edhe pagesën prej 100.00 Euro që parashihet me nenin 7, të Rregullores për Tarifën Vjetore të Licencës (KPM - 2017/06).
4. Departamenti i Licencimit, më datën 22 tetor 2018, përmes e-maili ka kërkuar nga parashtruesi i kërkesës plotësimin e kërkesës për ndryshimin e skemës programore të ZICO TV.

#### Arsyetimi

5. Neni 14, paragrafi 1, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së përcakton:

*“I Licencuari duhet që në transmetimet e veta, si një nga kushtet e Licencës, t’i përmbahet formatit dhe strukturës së përgjithshme të programit në bazë të të cilit i është dhënë Licenca dhe e drejta e përdorimit të spektrit të frekuencës. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me këtë mund të rezultojë deri në anulimin e Licencës”.*

6. Ndërsa Neni 14, paragrafi 2, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së përcakton:

*“I Licencuari obligohet që paraprakisht ta njoftojë me shkrim KPM-në lidhur me propozimin për ndryshime të mëdha të tipit ose burimit të programeve të dhëna në Pjesën 3 të Licencës ose të propozimit të heqjes së një përbërësi të formatit të licencuar. KPM-ja do ta njoftojë të Licencuarin me kohë, në rast se këto ndryshime të propozuara përputhen me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca, dhe nëse ato janë të tilla, do të ndryshojë Pjesën 3 të licencës së transmetimit në përputhje me kërkesën e të licencuarit.”*

7. Ndërsa Neni 2, i Pjesës së tretë të licencës së KPM-së - Formati i Programit, thekson:

*“Nga i Licencuari kërkohet që të njoftojë paraprakisht KPM-në për ndryshime të rëndësishme të cilat ai i propozon t’i bëjë në formatin e programit siç është përcaktuar në Pjesën 3 të Licencës. KPM-ja do ta njoftojë me kohë të Licencuarin nëse këto ndryshime të propozuara janë në përputhje me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca e parë, dhe nëse ato janë të tilla, KPM do të ndryshojë Pjesën 3 të Licencës në përputhje me kërkesat e të licencuarit.”*

8. ZICO TV është licencuar nga KPM, si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audovizuale për transmetim të programit përmes operatorëve të shpërndarjes, me përmbajtje të skemës programore, kryesisht program muzikor, ndërsa, në vitin 2017, me miratim të KPM-së ka ndryshuar skemën programore duke reduktuar programin muzikor dhe duke shtuar programin me interes publik.
9. Më datën 22 nëntor 2017, KPM, ka miratuar kërkesën për ndryshimin e pronësisë së ZICO TV, ndërsa, pronari i ri ka kërkuar që të ndryshojë skemën programore të ZICO TV, duke u kthyer në kanal tematik, i cili do të transmetoj kryesisht program muzikor, për arsye se nuk është në gjendje që tani për tani të realizoj skemën e re programore.
10. Komisioni konstaton se, kërkesa për ndryshimin e skemës programore është e kompletuar. Parashtruesi i Kërkesës ka ofruar informacione të qarta lidhur me ndryshimet e segmenteve programore si dhe ka kryer pagesën e tarifës administrative për ndryshime ne licencë në vlerë prej njëqind (100) eurove, e përcaktuar me Rregulloren KPM - 2017/06.



11. Komisioni konsideron që kërkesa e parashtruar është e kompletuar në pajtim me Procedurat e KPM-së për ndryshim të skemës programore, dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

### VENDIM

12. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 17 qershor 2019, merr vendim që ta miratojë kërkesën e ZICO TV, për ndryshimin e skemës programore, duke u kthyer në kanal tematik për transmetimin e programit me përmbajtje kryesisht muzikë.

13. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



17.06.2019

datë